



Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus+, në Saxion University of Applied Sciences, Holandë

Në kuadër të programit Erasmus + dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Saxion University of Applied Sciences.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve të nivelit Bachelor për studime.

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** - (Studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin Politeknik të Tiranës dhe të kenë përfunduar vitin e parë akademik).

Kohëzgjatja e bursave:

- Bachelor - 1 semestër, (semestri i dytë, i vitit akademik 2023 - 2024)

Fushat e studimit: Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, **viti i dytë dhe i tretë i studimit**
Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit

- Architecture (to Urban Planning or to Urban Design or to Climate & Management)
- Urban Planning (to Urban Planning, Urban Design or Public Management or Climate & Management)
- Civil Engineering (to Climate & Management)
- IT/Cyber/Media, to the programmes of our School of Creative Technology.
- Cyber IT, to Business Continuity Management or Crisis & Disaster Management.

Numri total i studentëve: 9 studentë

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët Bachelor:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve Bachelor deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj*;
- Dokumenti Learning Agreement**.

**Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar gjuhën duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.*

***Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility*



Key Action 1
- Mobility for learners and staff -

Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Saxion University of Applied Sciences lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillonit lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” te seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga Koordinatori Akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e “Learning Agreement” klikoni te:

[Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\)](https://upt.edu.al) , aneks 2.

Për t’u njohur me lëndët që ofrohen në Saxion University of Applied Sciences, sipas niveleve dhe fushave të studimit, klikoni në link-et:

[Course overview | Saxion](#)

Afati për aplikim: Deri më 10 tetor 2023, ora 12.00

Aplikimi kryhet pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, mund të kontaktoni në e-mail:
abeqo@upt.al , rkodra@upt.al